

RELACION PËR RISHIKIM E APLIKIMIT TË TARIFAVE PËR PERIU DHËN E TRETË RREGULLATORE PËR VITET 2012-2014

Po ju paraqesim më poshtë arsyet, hipotezat, agumentat dhe përlogaritjet tona për aplikimin e tarifave të energjisë elektrike për KESH Gen dhe Furnizuesin Publik me Shumicë.

I. QËLLIMI

Ky dokument ka për qëllim të sqarojë dhe argumentojë kërkesën e KESH sh.a. drejtuar Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me rishikim e tarifave të energjisë elektrike për KESH Gen dhe Furnizuesin Publik me Shumicë për vitet 2012-2014. Rishikimi i tarifave të energjisë elektrike do të krijojë mundësinë e ushtrimit normal të aktiviteteve të dy prej të licënsuarve në tregun shqiptar të energjisë elektrike. Miratimi i drejtë i tyre përbën një kusht të domosdoshëm për përmirësimin e situatës financiare të KESH sh.a. duke bërë që KESH-i të jetë vertet një kompani tregtare që mbulon me burimet e veta të gjithë shpenzimet operative të vitit dhe koston lokale të investimeve dhe i pavarur financiarisht nga Buxheti i Shtetit.

Propozimi i rishikimit të tarifave nga ana e KESH sh.a. për vitet 2012-2014 është mbështetur në reformën afatgjatë të tarifave, e cila është e koordinuar me reformat e tjera të sektorit dhe ka për **qëllim përfundimtar furnizimin e pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike të gjithë konsumatorëve të Republikës së Shqipërisë, me koston më të ulët të mundshme.**

Duke qenë se, KESH Gen dhe Furnizuesi Publik me shumicë, janë pjesë e strukturave të KESH sh.a., në materialin e përgatitur, do të trajtohen në të njëjtin dokument por në mënyre të ndarë, përlogaritjet tona për sejcilën nga tarifatat e kërkuara.

II. HYRJE

Manaxhimi i burimeve financiare me të cilën është përballur KESH sh.a. gjatë viteve të fundit, duke patur si objekt kryesor furnizimin sa më të plotë me energji elektrike të konsumatorëve, të orientuara dhe nga strategjitë për përparësitë e Qeverisë, kanë rezultuar në një akumulim të defiçiteve në likuiditetet e kompanisë gjatë këtyre viteve, duke konsideruar që dhe një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar kanë qenë dhe tarifatat e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet operative dhe investimet optimale për ta mirëmbajtur dhe fuqizuar atë. Në situatën aktuale, në zbatim të Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, rregullave dhe normave të përcaktuara nga institucionet përkatëse, KESH sh.a. është i fokusuar në detyrat dhe përgjegjësitë e veta të cilat burojnë nga këto norma.

Është mjaft e rëndësishme që në realizimin e detyrave të përcaktuara dhe ushtrimin e një aktiviteti normal dhe sa më cilësor të shërbimit, një pasqyrim real i tarifave të ushtrimit të këtij aktiviteti, do të ishte thelbësor.

VLERËSIMI I TARIFËS PËR VITIN 2012

Bazuar në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga ERE, nga ana e KESH sh.a. me shkresën Nr.DEK 4083 Prot. datë 31/08/2011, është dërguar Aplikimi mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH Gen. (KESH sh.a.) dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike të Furnizuesit Publik me Shumicë (KESH sh.a.) për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.

Me shkresën Nr.DEK/PL 4083/1 Prot., datë 16/09/2011, është dërguar pranë ERE-s, rishikimi i Aplikimit mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH Gen. (KESH sh.a.) dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike të Furnizuesit Publik me Shumicë (KESH sh.a.) për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, duke marrë parasysh faktin e krijimit të shoqërive "HEC Ulëz-Shkopet" sh.a., "HEC Bistrica1, Bistrica 2" sh.a. dhe "HEC Lanabregas" sh.a. dhe shkëputjes së aktivitetit të tyre nga ai i KESH sh.a.

Si në aplikim ashtu edhe gjatë rishikimit të tij nga ana e KESH sh.a. ishte marrë në konsideratë mbulimi i të gjitha kostove që pritej të realizoheshin për ushtrimin e aktivitetit normal në funksion të një shërbimi sa më të plotë dhe cilësor.

Nga ana e KESH sh.a. ishte marrë në konsideratë objektivi kryesor i kompanisë për furnizimin sa më të plotë me energji elektrike të konsumatorëve si dhe zbatimin e metodologjisë për mbulimin e kostove operacionale dhe kostove kapitale.

Duke u nisur nga kërkesa e ardhur nga CEZ Shpërndarje për energjinë e nevojshme për konsumatorët fundorë, rishikimi i kësaj kërkesë nga ana e tyre, nga parashikimi i prodhimit të energjisë nga ana e KESH Gen., TEC Vlorë, HEC-et e shkëputura, HEC-et Privatë dhe me Konçesion, si dhe në zbatimin e metodologjisë së lartpërmendur, nga ana e KESH sh.a. në seancën dëgjimore të zhvilluar nga ana e ERE-s, më datë 30.11.2011, nga ana e KESH sh.a. u kërkua tarifa mesatare për KESH Gen. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, të ishte 1.03 lekë/kWh nga 0.63 lekë/kWh, tarifa e vitit 2011 për KESH Gen., dhe tarifa e nevojshme për FPSH-në për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 të ishte 5.03 lekë/kWh, nga 1.48 lekë/kWh që ishte për vitin 2011.

Nga ana e ERE-s me shkresën Nr.794 Prot. datë 21.12.2011 është dërguar pranë KESH sh.a. Vendimet Nr.144, datë 07.12.2011 ku janë përcaktuar tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. (KESH Gen.) për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, e cila ishte 1.00 lekë/kWh si dhe Vendimi Nr.145, datë 07.12.2011 ku ishte përcaktuar tarifa e energjisë elektrike për FPSH-në për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, e cila ishte 2.83 lekë/kWh, si dhe relacioni përkatës që shoqëronte llogaritjen e këtyre tarifave.

Në tarifën e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 nga KESH sh.a. (KESH Gen.), axhustimi kryesor nga ana e ERE-s lidhej me të ardhurat e kërkuara neto nga të cilat zbritet shuma prej 1,517 milionë lekë dhe prodhimi 3 vjeçar nga të cilat zbritet prodhimi prej 1,095 MWh.

Zërat	Njësia	ERE			KESH		
		2012	2013	2014	2012	2013	2014
Mirëmbajtje	(mil. lekë)	212	205	215	268	265	278
Personeli	"	995	1,046	1,100	1,442	1,513	1,594
Furnitura e Shërbime	"	680	716	755	752	774	798
Totali OPEX	(mil. lekë)	1,887	1,967	2,070	2,462	2,552	2,670
Vlera e asetëve	(mil. lekë)	34,257	36,528	40,143	38,693	41,379	43,583
Amortizimi i akumuluar	"	6,543	7,223	7,939	7,731	8,570	9,453
Vlera neto e Asetëve	"	27,714	29,305	32,204	30,962	32,809	34,130
Kapitali i Punës	(mil. lekë)	157	164	173	205	213	223
Investime	"	2,271	3,615	2,446	4,542	2,687	2,204
Amortizim i vitit	"	680	716	755	838	883	930
Baza e Rregulluar e Asetëve (RAB)	(mil. lekë)	29,462	32,368	34,068	34,871	34,826	35,627
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	(%)	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%
Raporti i Synuar i Kapitalit të Vet	"	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kosto Mesatare e borxhit	"	5.26%	4.80%	4.50%	5.26%	4.80%	4.50%
Raporti i Synuar i Borxhit	"	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%	60.00%
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	6.09%	5.82%	5.64%	6.09%	5.82%	5.64%
Fitimi	(mil. lekë)	1,794	1,882	1,921	2,124	2,025	2,009
arketuar nga OST humbje	"				(226)	(232)	(240)
te ardhura nga interesat	"	(1,001)	(901)	(802)	(1,001)	(901)	(802)
Të Ardhurat e Kërkuara	(mil. lekë)	3,361	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Eksporti i energjisë Elektrike	(mil. lekë)						
axhustim i te ardhurave per vitin 2011	"	596					
Te ardhurat e kerkuara minus Eksportin	"	3,957	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Të Ardhurat e Kërkuara Neto	(mil. lekë)	3,957	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Energjia e Prodhuar	GWh	3,837	3,837	3,837	3,832	4,386	4,388
Tarifa Mesatare e Prodhimit	lekë/kWh	1.03	0.96	1.03	1.10	0.99	1.04
Tarifa Mesatare e Prodhimit 2012-2014	lekë/kWh			1.00			1.03

Në tarifën e energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 për FPSH-në, axhustimet nga ana e ERE-s lidhen me koston totale të energjisë nga e cila është zbritur shuma prej 31,671 milionë lekë, ku pjesën kryesore e zë ulja e të ardhurave të kërkuara nga koston e importit me 24,678 milionë lekë, ulja e të ardhurave të kerkuara nga kosto e energjisë së TEC Vlorë me 10,771 milionë lekë, rritja e të ardhurave nga IPP-të e ndarë me 2,908 milionë lekë dhe ulja e të ardhurave nga kosto fiksë e TEC Vlorë me 9,038 milionë lekë.

Gjithashtu axhustim është bërë dhe kompensimet e të ardhurave nga periudhat e mëparshme me një rritje me 5,606 milionë lekë.

Energjia e shitur është axhustuar duke e ulur me 3,913 GWh për periudhë e tretë rregullatore.

Me Vendimin Nr.87 datë 29.06.2012, ERE vendosi reduktimin e tarifës së FPSH-së për periudhën e tretë rregullatore nga 2.83 lekë/kWh në 2.20 lekë/kWh, shoqëruar kjo dhe me relacionin përkatës drejtuar KESH sh.a. me shkresën Nr.478/2 Prot., datë 17.02.2012.

Më poshtë jepet tabela me llogaritjen analitike të zërave të tarifës së FPSH-së në Vendimin Nr. 145, datë 07.12.2011 ku ishte përcaktuar tarifa e energjisë elektrike për FPSH-në për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, e cila ishte 2.83 lekë/kWh.

Zërat	Njësia	ERE			KESH		
		2012	2013	2014	2012	2013	2014
Blerë energji nga Prodhuesi Publik	(GWh)	3,611	3,609	3,610	3,974	3,900	3,880
Çmimi i prodhimit të energjisë elektrike	(lekë/kWh)	1.03	0.96	1.03	0.80	0.85	0.91
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	3,724	3,448	3,711	3,166	3,329	3,530
Importi i energjisë	(GWh)	0	33	193	938	1,164	1,196
Kosto e Importit	(lekë/kWh)	8.02	8.02	8.06	8.02	8.02	8.06
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	0	265	1,556	7,523	9,335	9,640
Blerje energjie nga PVE	(GWh)	228	270	280	261	270	280
Çmimi i PVE	(lekë/kWh)	8.10	8.30	8.20	7.86	7.84	7.83
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	1,847	2,241	2,296	2,051	2,117	2,192
Blerje energjie nga TEC Vlorë	(GWh)	72	0	0	246	246	390
Kosto e TEC Vlorë	(lekë/kWh)	21.41			13.68	14.22	13.98
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	1,542	0	0	3,365	3,498	5,452
Blerje energjie nga IPP ndarë	(GWh)	200	363	363			
Çmimi i PVE	(lekë/kWh)	3.14	3.14	3.14			
Kosto Totale e Prodhimit Publik	(mil. lekë)	628	1,140	1,140	0	0	0
Kosto Totale e Energjisë	(mil. lekë)	7,740	7,093	8,702	16,106	18,279	20,814
Shpenzime për personelin	(mil. lekë)	31	31	31	31	31	32
Materiale	"	2	2	2	2	2	2
Furnitura e Shërbime	"	8	9	9	8	9	9
Shpenzime për interesa	"	848	848	848	848	848	848
Kosto fikse TEC Vlorë	"	1,409	1,500	1,500	3,982	3,982	5,483
Totali i të Ardhurat të Kërkuara	(mil. lekë)	10,038	9,483	11,092	20,977	23,151	27,189
Marzhi i Fitimit (0.5% e të ardhurave)	(mil. lekë)	46	43	51	100	111	131
Kompensim për llogaritjen e të ardhurave të FPSH për vitin 2011	"	5,200		697			
Kompensim i të ardhurave nga eksporti i vitit 2010	"	-2,050	1,200	2,100			
Rillogaritje/kompensim I të ardhurave nga TEC Vlorë	"	-1,541					
Totali i të Ardhurave të Kërkuara Neto	(000/lekë)	11,693	10,727	13,940	21,077	23,262	27,320
Energjia e shitur	GWh	4,111	4,275	4,446	5,419	5,580	5,746
Tarifa e FPSH-së	lekë/kWh	2.84	2.51	3.14	5.82	4.17	4.75
Tarifa Mesatare e FPSH-së 2012-2014	lekë/kWh			2.83			5.03



RISHIKIMI I TARIFËS
PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014
(KESH sh.a. – KESH Gen.)

KESH sh.a. (KESH Gen.)


Impjantet Hidroenergjetike dhe Termoenergjetike

Me funksionimin si shoqëri aksionere të HEC Ulëz-Shkopet, HEC Bistricë dhe HEC Lanabregas në zbatim të Ligjit nr.10.430, dt. 09.06.2011 “Për krijimin e shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet sh.a.”, “HEC Lanabregas sh.a.” dhe “HEC Bistricë sh.a.”, KESH Gen. operon vetëm me 3 (tre) hidrocentrale, të vendosura në kaskadën e lumit Drin dhe Termocentralin e Fierit.

Kapaciteti Prodhues

KESH sh.a. është një kompani prodhuese e energjisë elektrike, e cila 100% të prodhimit të saj e realizon nëpërmjet hidrocentraleve. Impjantet prodhuese me fuqi më të madhe janë instaluar kryesisht në veri të vendit në kaskadën e lumit Drin në tre njësitë hidrike; atë të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës.

Njësia Gjeneruese	Numri i Agregatëve	Fuqia e instaluar (MW)	Viti i Komisionimit
HEC Fierza	4	500	1978
HEC Koman	4	600	1985
HEC Vau i Dejës	5	250	1971
Total	13	1350	



Informacion i Përgjithshëm

HEC Fierza ndodhet në pjesën veri-lindore të Shqipërisë në fillim të kaskadës së lumit Drin pranë qytetit të Bajram Currit. Bazeni i këtij HEC-i ka një kapacitet prej 2.7 miliardë m³ ujë. Impianti është vënë në punë në dy faza: në vitin 1975 u vunë në punë njësitë 1, 2 dhe 3 ndërsa njësia 4 në vitin 1978. Diga është 190 metra e lartë. Ka dy tunele furnizimi që çojnë ujin në të katër njësitë e instaluara. Kapaciteti i instaluar është 500 MW me një prodhim mesatar vjetor prej 1,800 GWh. Impianti është i lidhur me rrjetin 220 kV të transmetimit.

HEC Koman u ndërtua në Lumin Drin në pjesën veri-lindore të Shqipërisë në mes të kaskadës së Drinit. Bazeni i këtij HEC-i ka një kapacitet prej 450 milion m³ ujë. Impianti u vu në punë në dy faza: njësitë 1, 2 dhe 3 në vitin 1985, dhe njësia 4 është vënë në punë në vitin 1988. Diga është e lartë 125 m. Dy tunele furnizojnë me ujë të katër turbinat që ndodhen në sallën e turbinave. Kapaciteti i instaluar i HEC Koman është 600 MW dhe prodhimi mesatar vjetor 2,060 GWh. Impianti është i lidhur me rrjetin 220 kV të transmetimit.

HEC Vau-Dejës ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë, në fund të kaskadës së lumit Drin, pranë qytetit të Shkodrës. Bazeni i këtij HEC-i ka një një kapacitet prej 580 milion m³ ujë. Edhe ky impiant është vënë në punë në dy faza: njësia 1, 2 dhe 3 në vitin 1970, dhe njësia 4 dhe 5 në vitin 1975. Diga është 90 metra e lartë. Ka dy tunele furnizimi që çojnë ujin për të pesë njësitë e instaluara. Kapaciteti i instaluar është 250 MW me një prodhim mesatar vjetor prej 1,000 GWh. Impianti është i lidhur me rrjetin 220 kV të transmetimit.

Prodhimi Bruto mujor sipas Njësive për periudhën 2007-2014

Në tabelën e mëposhtme jepet në menyrë analitike prodhimi aktual bruto mujor i njësive të KESH Gen. për periudhën Janar 2007-Korrik 2012 si dhe parashikimi për periudhën Gusht-Dhjetor 2012 dhe vitet 2013-2014.

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2007
HEC Fierzë	64,325	33,763	48,082	60,204	78,298	82,691	78,706	54,757	44,452	37,769	22,753	84,347	690,146
HEC Koman	117,340	98,300	112,610	105,250	119,380	103,100	90,450	64,720	68,420	68,760	108,580	142,880	1,199,790
HEC Vau i Dejës	62,371	57,506	61,732	54,530	61,840	50,920	43,383	31,598	33,551	34,387	60,786	77,385	629,988
HEC Theth													0
TEC Fier	20,771	13,712	5,709	1,916	0	0	0	0	0	12,067	15,559	2,647	72,380
Total KESH Gen.	264,807	203,281	228,132	221,900	259,518	236,711	212,539	151,074	146,423	152,982	207,678	307,259	2,592,304

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2008
HEC Fierzë	120,807	112,371	45,056	92,232	97,365	76,565	140,805	110,075	80,770	91,913	51,749	51,926	1,071,634
HEC Koman	162,120	128,130	129,230	139,660	131,460	103,240	129,390	113,170	94,490	116,920	107,020	197,150	1,551,980
HEC Vau i Dejës	86,864	66,157	75,399	74,637	65,767	53,271	64,635	53,333	46,071	61,199	58,166	111,934	817,432
HEC Theth													0
TEC Fier	0												0
Total KESH Gen.	369,790	306,658	249,684	306,529	294,592	233,076	334,830	276,578	221,331	270,032	216,936	361,010	3,441,046

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2009
HEC Fierzë	111,170	171,992	127,822	218,057	165,008	108,553	131,883	117,697	97,503	74,662	109,551	123,460	1,557,357
HEC Koman	187,290	217,180	173,490	250,330	199,070	130,760	139,050	114,630	97,650	131,610	200,870	220,120	2,062,050
HEC Vau i Dejës	106,399	117,322	95,230	126,931	102,672	64,211	68,915	55,702	47,627	72,372	111,778	116,173	1,085,330
HEC Theth													0
TEC Fier													0
Total KESH Gen.	404,859	506,494	396,542	595,318	466,750	303,524	339,848	288,029	242,779	278,644	422,199	459,752	4,704,738

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2010
HEC Fierzë	302,308	233,318	308,605	295,857	285,764	190,870	122,843	119,029	78,505	195,876	209,590	326,095	2,668,658
HEC Koman	286,180	264,510	306,890	291,960	304,940	211,490	124,390	116,310	94,650	251,570	299,650	320,190	2,872,730
HEC Vau i Dejës	153,615	151,867	163,733	154,704	158,781	107,283	58,882	55,834	47,883	137,315	148,879	172,440	1,511,215
HEC Theth													0
TEC Fier													0
Total KESH Gen.	742,103	649,695	779,228	742,521	749,484	509,642	306,115	291,172	221,039	584,761	658,119	818,725	7,052,603

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2011
HEC Fierzë	305,321	143,379	126,084	67,032	39,508	74,273	97,120	106,278	82,849	110,080	60,092	23,960	1,235,975
HEC Koman	313,950	171,630	174,080	104,730	97,200	95,350	101,690	114,730	90,870	128,110	77,430	149,230	1,619,000
HEC Vau i Dejës	153,415	86,554	90,748	53,894	49,491	46,492	49,505	54,787	44,796	64,247	37,783	84,021	815,733
HEC Theth	7	8	6	5	4	10	4	1	0	1	0	2	48
TEC Fier													0
Total KESH Gen.	772,693	401,571	390,919	225,661	186,203	216,126	248,319	275,795	218,515	302,438	175,305	257,212	3,670,757

KESH Gen.	Fakti							Parashikimi					Viti 2012
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	111,771	102,564	37,835	18,822	89,961	192,932	179,355	85,031	90,375	94,569	111,990	110,736	1,225,940
HEC Koman	159,822	143,088	98,380	144,590	155,330	200,740	170,330	91,229	96,632	112,189	140,886	153,523	1,666,739
HEC Vau i Dejës	85,967	77,773	47,719	84,444	82,219	101,650	83,151	46,867	49,728	58,341	74,266	95,157	887,282
HEC Theth	4	3	3	4	9	0	0						23
TEC Fier													0
Total KESH Gen.	357,563	323,428	183,936	247,860	327,518	495,322	432,836	223,128	236,735	265,099	327,143	359,416	3,779,984

KESH Gen.	Parashikimi												Viti 2013
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	99,235	91,061	33,592	16,711	79,871	171,294	159,240	75,495	80,239	83,963	99,430	98,316	1,088,447
HEC Koman	162,743	145,703	100,178	147,232	158,169	204,409	173,443	92,896	98,398	114,239	143,461	156,329	1,697,199
HEC Vau i Dejës	104,285	94,346	57,887	102,438	99,739	123,311	100,870	56,854	60,324	70,773	90,092	115,434	1,076,354
Total KESH Gen.	366,263	331,110	191,657	266,382	337,778	499,014	433,553	225,246	238,961	268,975	332,983	370,079	3,862,000

KESH Gen.	Parashikimi												Viti 2014
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	99,235	91,061	33,592	16,711	79,871	171,294	159,240	75,495	80,239	83,963	99,430	98,316	1,088,447
HEC Koman	162,743	145,703	100,178	147,232	158,169	204,409	173,443	92,896	98,398	114,239	143,461	156,329	1,697,199
HEC Vau i Dejës	104,285	94,346	57,887	102,438	99,739	123,311	100,870	56,854	60,324	70,773	90,092	115,434	1,076,354
Total KESH Gen.	366,263	331,110	191,657	266,382	337,778	499,014	433,553	225,246	238,961	268,975	332,983	370,079	3,862,000

Humbjet mujore sipas Njësive për periudhën 2007-2014

Tabela e mëposhtme tregon të dhënat analitike në lidhje me nivelin e humbjeve të njësive të gjenerimit për periudhën 2007-2012. Duhet të kihet parasysh se në mungesë të një mekanizmi të saktë për llogaritjen e humbjeve gjatë këtyre viteve, është përdorur llogaritja në bazë përqindje. Kështu për periudhën Janar 2007 – Qershor 2007, humbjet në impjantet gjeneruese llogariteshin si 1.5% e prodhimit bruto për njësi; për periudhën Korrik 2007 – Dhjetor 2007, humbjet në impjantet gjeneruese llogariteshin si 0.7% e prodhimit bruto për njësi; për vitin 2008 llogariteshin si 0.32% e prodhimit bruto për impjantet e mëdha.

Informacioni për periudhën Janar 2009- Korrik 2012 si dhe parashikimi për periudhën Gusht-Dhjetor 2012 dhe vitet 2013-2014 bazohet në matje reale parashikime të sakta për llogaritjen e humbjeve.

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2007
HEC Fierzë	965	506	721	903	1,174	1,240	551	383	311	264	159	590	7,770
HEC Koman	1,760	1,475	1,689	1,579	1,791	1,547	633	453	479	481	760	1,000	13,646
HEC Vau i Dejës	936	863	926	818	928	764	304	221	235	241	426	542	7,201
TEC Fier	312	206	86	29						91	117	20	861
Total KESH Gen.	3,973	3,050	3,422	3,329	3,893	3,551	1,488	1,058	1,025	1,077	1,462	2,152	29,478

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2008
HEC Fierzë	387	360	144	295	312	245	451	352	258	294	166	166	3,429
HEC Koman	519	410	414	447	421	330	414	362	302	374	342	631	4,966
HEC Vau i Dejës	278	212	241	239	210	170	207	171	147	196	186	358	2,616
Total KESH Gen.	1,183	981	799	981	943	746	1,071	885	708	864	694	1,155	11,011

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2009
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	1,947	2,400	1,804	2,273	1,728	1,133	1,362	912	844	1,263	2,033	2,331	20,031
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	1,947	2,400	1,804	2,273	1,728	1,133	1,362	912	844	1,263	2,033	2,331	20,031

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2010
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	3,177	2,703	3,038	2,436	2,219	1,738	1,168	1,094	814	2,332	2,784	3,158	26,663
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	3,177	2,703	3,038	2,436	2,219	1,738	1,168	1,094	814	2,332	2,784	3,158	26,663

KESH Gen.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti 2011
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	2,875	1,415	1,431	1,171	910	909	1,044	865	812	1,032	948	1,390	14,800
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	2,875	1,415	1,431	1,171	910	909	1,044	865	812	1,032	948	1,390	14,800

KESH Gen.	Fakti							Parashikimi					Viti 2012
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	1,585	1,562	1,006	1,434	1,433	1,615	1,336	983	923	1,173	1,078	1,580	15,706
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	1,585	1,562	1,006	1,434	1,433	1,615	1,336	983	923	1,173	1,078	1,580	15,706

KESH Gen.	Parashikimi												Viti 2013
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	1,917	1,889	1,217	1,734	1,734	1,954	1,616	1,189	1,116	1,419	1,304	1,912	19,000
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	1,917	1,889	1,217	1,734	1,734	1,954	1,616	1,189	1,116	1,419	1,304	1,912	19,000

KESH Gen.	Parashikimi												Viti 2014
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
HEC Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Koman	1,917	1,889	1,217	1,734	1,734	1,954	1,616	1,189	1,116	1,419	1,304	1,912	19,000
HEC Vau i Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total KESH Gen.	1,917	1,889	1,217	1,734	1,734	1,954	1,616	1,189	1,116	1,419	1,304	1,912	19,000

Pagat e Punonjësve

Bazuar në të dhënat e 6-mujorit të parë të vitit 2012 më poshtë do të gjeni informacion për numrin e punonjësve dhe pagën mesatare sipas nivelit për çdo njësi gjeneruese.

KESH GEN.	Njësia	Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	Specialistë	Teknikë dhe ndihmës specialist	Nëpunës të thjeshtë	Punetorë	Totali
KESH Gen.							
Numri i punonjësve	Nr.	24	47	104	1	249	425
Fondi i Pagave	Mil.Lekë	11,309	17,691	28,890	312	61,606	119,808
Paga mesatare	Lekë	78,535	62,734	46,298	52,000	41,236	46,984
HEC Fierza							
Numri i punonjësve	Nr.	12	6	13	1	114	146
Fondi i Pagave	Mil.Lekë	5,298	2,747	4,164	312	27,498	40,019
Paga mesatare	Lekë	73,583	76,306	53,385	52,000	40,202	45,684
HEC Koman							
Numri i punonjësve	Nr.	3	23	86	0	24	136
Fondi i Pagave	Mil.Lekë	1,671	8,347	23,307	0	4,963	38,288
Paga mesatare	Lekë	92,833	60,486	45,169		34,465	46,922
HEC Vau Dejës							
Numri i punonjësve	Nr.	9	18	5	0	111	143
Fondi i Pagave	Mil.Lekë	4,340	6,597	1,419	0	29,145	41,501
Paga mesatare	Lekë	80,370	61,083	47,300		43,761	48,369

TË DHËNA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

Baza e Aktiveve të Rregulluara

Aktive Fikse në operim

Kërkesat për aktivet afatgjata për çdo impjant prodhues si dhe për Aparatin Qëndror të KESH sh.a. për vitin 2012-2014 jepet sipas tabelës së mëposhtme:

Llog	Kategoritë e AAGJ (sipas sistemit uniform të llog)	Vlera e mbetur e Aktiveve Afatgjata 31.12.2011						Totali Aseteve
		Aparati Qëndror	Fierza	Koman	Vau i Dejës	HEC-et Lokale	Tec Fier	
200	Llogaritë e aktiveve të qëndrueshme							0
208	Të tjera A.Q të patrupëzuara	9	0	0	0	0	0	10
210	Aktiv. Qendrushme të trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
211	Toka	30	287	369	91	0	0	777
212	Ndërtesa	221	8,897	5,892	4,352	8	0	19,371
213	Makineri, pajisje	1	4,114	1,334	3,359	63	59	8,930
215	Mjete transporti	59	77	142	44	0	0	322
218	Inventar ekonomik, pajisje zyre dhe informatike	97	12	11	12	1	2	135
Totali Aktive Afatgjata Materiale		417	13,387	7,749	7,857	72	62	29,545
Shtesa të Aktiveve Afatgjata gjatë vitit 2012		0	275	1,433	478	0	0	2,186
Totali i AAGJ 31.12.2012		417	13,662	9,182	8,335	72	62	31,731
Shtesa të Aktiveve Afatgjata gjatë vitit 2013		0	816	2,344	580	0	0	3,740
Totali i AAGJ 31.12.2013		417	14,478	11,526	8,915	72	62	35,471
Shtesa të Aktiveve Afatgjata gjatë vitit 2014		0	659	1,894	540	0	0	3,093
Totali i AAGJ 31.12.2014		417	15,137	13,420	9,455	72	62	38,564

(milionë lekë)

Në llogaritjen e tarifës së KESH Gen. për periudhën rregullatore 2012-2014, është marë për bazë vlera kontabël historike.

Amortizimi i akumuluar

Në tabelën e mëposhtme jepet amortizimi i akumuluar për të gjithë kategoritë e aktiveve për periudhën e fundit ushtrimore (31.12.2011) si dhe për atë rregullatore (2012-2014) për çdo njësi gjeneruese.

(milionë lekë)

Llog	Kategoritë e AAGJ (sipas sistemit uniform të llog)	Vlera e Amortizimit të Akumuluar 31.12.2011						
		Aparati Qëndror	Fierza	Koman	Vau i Dejës	HEC-et Lokale	Tec Fier	Totali i Amortizimit
	Amortizime të aktiveve të qëndrueshme							0
280,000	Amortizime të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	2	0	0	0	0	0	2
281,000	Amortizime të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
282,000	Amortizime për ndërtesat	7	1,270	839	812	1	0	2,929
283,000	Amortizime për makineri dhe pajisje	1	1,075	1,062	1,254	19	44	3,455
285,000	Amortizimi i mjeteve të transportit	16	25	54	9	0	0	105
288,000	Amortizimi i inventarit ekonomik, pajisje zyre dhe informatike	49	7	8	8	1	2	76
	Amortizimi i Akumuluar 31.12.2011	76	2,378	1,964	2,083	20	46	6,567
	Amortizimi i vitit 2012	23	311	123	234	2	3	696
	Amortizimi i Akumuluar 31.12.2012	99	2,688	2,087	2,317	23	49	7,263
	Amortizimi i vitit 2013	24	326	129	246	3	3	731
	Amortizimi i Akumuluar 31.12.2013	123	3,014	2,216	2,563	25	53	7,994
	Amortizimi i vitit 2014	25	342	135	258	3	4	767
	Amortizimi i Akumuluar 31.12.2014	148	3,357	2,351	2,821	28	56	8,762

Investimet

Në lidhje me planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, për njësitë e KESH Gen. janë parashikuar për vitin 2012 rreth 2,186 milionë lekë, për vitin 2013 rreth 3,740 milionë lekë dhe për vitin 2014 rreth 3,093 milionw lekë.

Në tabelën e Aneksit 2 jepet plani i investimeve sipas njësive të KESH Gen. për periudhën 2012-2014.

Kosto e Kapitalit

ROE

Llogaritja e normës së kthimit mbi kapitalin të Kompanisë Publike të Gjenerimit është bazuar në rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 mujore të kryera nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2012. Mesatarja e periudhës e llogaritur deri në ankandin e fundit të zhvilluar për BTH 12M më datë 16 Gusht 2011 është 7.34%.

Rezultatet e ankandeve të Bonove të Thesarit 12 Mujore BSH, Viti 2012

Data e Ankandit	Data e Emetimit	Yield-i mesatar i ponderuar i pranuar
29-Dec-11	3-Jan-12	7.04%
10-Jan-12	12-Jan-12	7.11%
31-Jan-12	2-Feb-12	7.00%
14-Feb-12	16-Feb-12	7.21%
28-Feb-12	1-Mar-12	7.32%
13-Mar-12	15-Mar-12	7.34%
27-Mar-12	29-Mar-12	7.33%
10-Apr-12	12-Apr-12	7.35%
30-Apr-12	3-May-12	7.35%
15-May-12	17-May-12	7.37%
29-May-12	31-May-12	7.34%
12-Jun-12	14-Jun-12	7.38%
26-Jun-12	28-Jun-12	7.35%
10-Jul-12	12-Jul-12	7.34%
31-Jul-12	2-Aug-12	7.26%
14-Aug-12	16-Aug-12	7.20%
Mesatarja e Periudhës		7.27%

(Burimi i të dhënave nga faqja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org)

Kosto e borxhit

Kosto Mesatare e Borxhit për KESH Gen. është llogaritur duke marrë raportin e shumës totale të interesave neto për t'u paguar për kontratat e kredive afatgjata të cilat janë marrë në funksion të aktivitetit të KESH Gen. me gjendjen në fund të vitit të ketyre kontratave. Për vitin 2012 kosto mesatare e borxhit është 5.40%, për vitin 2013 është 4.99% dhe për vitin 2014 është 4.74%.

Eksportet dhe Importet e Energjisë

Eksportet

Gjatë vitit 2012 (periudha Maj-Qershor) nga ana e KESH Gen. është shitur me çmime tregu (eksport dhe tregu vendas) sasia e energjisë prej 297,776 MWh me një vlerë prej EUR 14,077,535 (pa TVSH) dhe me çmim mesatar prej 47.28 Eur/MWh ose 6.55 lekë/kWh. Ndërsa për vitin e ardhshëm nuk është parashikuar sasi energjie për t'u shitur me çmime tregu (eksport dhe tregu vendas) nga ana e KESH Gen.

Kontrata	Realizmi			Çmimi mesatar	
	Muaji	Sasia (MWh)	Vlera (Euro)	Vlera (Lekë)	EUR/MWh
Maj	87,600	5,118,000	711,862,620	58.42	8.13
Qershor	210,176	8,959,535	1,237,938,979	42.63	5.89
TOTALI	297,776	14,077,535.20	1,949,801,598.58	47.28	6.55

Importet

Gjatë vitit 2012 (periudha Janar-Prill) nga ana e FPSH-së është blerë me çmime tregu (import dhe tregu vendas) sasia e energjisë prej 262,360 MWh me një vlerë prej EUR 19,431,120 (pa TVSH) dhe me çmim mesatar prej 74.06 Eur/MWh ose 10.31 leke/kWh.

Kontrata	Realizmi			Çmimi mesatar	
	Muaji	Sasia (MWh)	Vlera (Euro)	Vlera (Lekë)	EUR/MWh
Janar	192,000	14,317,752	1,989,165,285	74.57	10.36
Shkurt	46,984	3,523,800	493,613,904	75.00	10.51
Prill	23,376	1,589,568	223,064,077	68.00	9.54
TOTALI	262,360	19,431,120	2,705,843,267	74.06	10.31

Shkëmbimet

Parashikimi i sasive të shkëmbimeve të energjisë për vitin 2012 rezultojnë në 58,714 MWh energji e dhënë dhe 60,486 MWh energji e marë e cila është kryesisht kthim i energjisë së depozituar më parë. Për vitet 2013-2014 nuk janë parashikuar shkëmbime energjie.

Rishikimi i Tarifës së KESH Gen. për periudhën rregullatore 2012-2014

Rishikimi i Tarifës së KESH Gen. është bazuar duke marë parasysh elementet e mëposhtëm:

Shpenzimet Operative - shpenzimet e personelit, materiale dhe produkte, shërbime (KESH Security, të tjera), asete të ndërtuara me fondet e veta, provizioni për borxhet, shpenzime të tjera.

Shpenzimet Kapitale – Investimet e vitit (Kosto lokale dhe e huaj), amortizimi, interesa.

RAB – AQT, Investimet e vitit, amortizimi i akumuluar, amortizimi i vitit, kreditë afatgjata, disbursimet dhe pagesat gjatë vitit për kreditë afatgjata.

WACC, Të Ardhurat e Kërkuara Neto, Prodhimi Neto nga KESH Gen.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë analitike elementet e kostos për përcaktimin e tarifës së KESH Gen.

Shpenzimet Operative - Për vitin 2012 shpenzimet operative janë llogaritur në vlerën 1,700 milionë lekë, për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 1,846 milionë lekë dhe për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 1,941 milionë lekë.

Më poshtë po japim në mënyrë analitike zërat e shpenzimeve operative.

Shpenzimet e Personelit – Për vitin 2012 shpenzimet e personelit janë llogaritur në vlerën 845 milionë lekë, për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 929 milionë lekë dhe për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 977 milionë lekë.

Materiale dhe Produkte – Për vitin 2012 shpenzimet për materiale dhe produkte janë llogaritur në vlerën 176 milionë lekë, për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 200 milionë lekë dhe për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 211 milionë lekë.

Shërbime

KESH Security – Për vitin 2012 shpenzimet për shërbimin e ofruar nga KESH Security për ruajtjen e objekteve të njëjësive të gjenerimit dhe Aparatit Qendër janë llogaritur në vlerën 274 milionë lekë, për vitin 2013 në vlerën 287 milionë lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 302 milionë lekë.

Shërbime të tjera – Për vitin 2012 shpenzimet për shërbimet e tjera janë llogaritur në vlerën 405 milionë lekë, për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 432 milionë lekë dhe për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 452 milionë lekë.

Shpenzimet Kapitale - Për vitin 2012 shpenzimet kapitale janë llogaritur në vlerën 2,186 milionë lekë, për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 3,740 milionë lekë dhe për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 3,093 milionë lekë.

Më poshtë po japim në mënyrë analitike zërat e shpenzimeve kapitale.

Amortizimi i Vitit - Për vitin 2012 amortizimi i vitit është llogaritur në vlerën 696 milionë lekë, për vitin 2013 është llogaritur në vlerën 731 milionë lekë dhe për vitin 2014 është llogaritur në vlerën 767 milionë lekë.

(Shënim: Kjo vlerë përfaqëson amortizimin historik të aktiveve të kompanisë).

Kapitali i Punës - Për vitin 2012 kapitali i punës është llogaritur në vlerën 142 milionë lekë (1/12 e shpenzimeve operative të vitit), për vitin 2013 është llogaritur në vlerën 154 milionë lekë (1/12 e shpenzimeve operative të vitit) dhe për vitin 2014 është llogaritur në vlerën 162 milionë lekë (1/12 e shpenzimeve operative të vitit).

